



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • eëë.filologjia.uni-pr.edu

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të gjuhës angleze

Nr. Prot.: 03/411

Datë: 30/1/2025

Mbështetur në Vendimin me nr. prot. 01/4891, datë 31.12.2024 të Fakultetit të Filologjisë dhe në zbatim të Konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës në vitin akademik 2024/25, me Nr.Prot.: 5/861, datë 30.12.2024, Komisioni për shqyrtimin e ankesave të për pjesën e njohurive të gjuhës angleze Fakultetit të Filologjisë, mori

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga kandidatja Mirjetë Sadiku, me Nr.Prot.: 04/253 dt. 23.1.2025.
- II. **VËRTETOHET** rezultati preliminar i testit nga gjuha angleze të provimit pranues në studimet e doktoratës për vitin akademik 2024/25, i shpallur me datë 22.1.2025.

### Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.1.2025, e shqyrtoi ankesën e parashtruar nga znj. Mirjetë Sadiku. Si rrjedhojë, komisioni ka vërtetuar rregullsinë e vlerësimit dhe konfirmon rezultatin preliminar. Ndërlidhur me pretendimet për pamundësimin dhe mohimin e të drejtës elementare për t'iu nënshtruar testit si për pjesën profesionale (me lloptop), Komisioni thekson faktin që një gjë e tillë është e pamundur për shkak të natyrës së testit – sikur testi i gjuhës angleze të bëhej në lloptop, atëherë disa nga përgjigjet do të rregulloheshin në mënyrë automatike, gjë që do të binte ndesh me trajtimin e barabartë të të gjithë kandidatëve në testim. Për më tepër, administratori i ka ofruar ndihmë kandidates në fjalë për pjesën 2B ku kërkohej plotësimi i përgjigjeve me fjalë të shkruara, mirëpo me qenë se shkrimi i kandidates ishte i lexueshëm, atëherë ajo u udhëzua që të vazhdonte të shkruante vet fjalët në fletëpërgjigje (answer sheet). Komisioni pas shqyrtimit konstaton se përgjigjet e kandidates nuk janë të sakta.

Duke marrë parasysh këtë çfarë u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### KOMISIONI:

1. Prof.asst. Blerta Mustafa - kryetare
2. Prof. Lirak Karjagdiu - anëtar
3. Asst. Zinaide Gruda - anëtare

